

KESHILLI I MINISTRAVE NOMINON FSASH DHE SPASH ANETARE TE KESHILLIT KOMBETAR TE PUNES NGA RADHET E ORGANIZATAVE TE PUNEMARRESVE

Mbas procedurave ligjore te zhvilluara nga Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise per percaktimin e organizatave te punedhenesve dhe punemarresve, (sindikatave), me te perfaqesuara ne vend, Keshilli i Ministrave i Republikes se Shqiperise, me Vendimin Nr. 1060, date 14. 12. 2013, percaktoi 10 organizatat me te perfaqesuara nga radhet e punedhenesve dhe 10 organizatat me te perfaqesuara nga radhet e punemarresve, (sindikatave).

Sic shihet edhe nga tekstet e VKM Nr.1060, date 14.12.2013 dhe Urdherit Nr. 287, date 18.12.2013, qe po i botojme ne kete numer, **Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, jane nominuar anetare te Keshillit Kombetar te Punes nga radhet e punemarresve, (sindikatave).**

Mbi bazen e ketij vendimi, Ministri i Ceshtjeve Sociale dhe Rinise, z. Erion Veliaj, me Urdherin Nr. 287, date 18.12.2013, emeroi anetaret dhe kandidatet e KKP nga radhet e punedhenesve dhe te punemarresve.

Sipas propozimeve te bera nga organizatat perkatese, FSASH dhe SPASH perfaqesohen ne kete organ te larte e te rendesishem nga kryetaret e tyre, z. Xhafer Dobrushli dhe z. Nevruz Kaptelli, te cilet jane emruar anetar te Keshillit Kombetar te Punes.

Me keto vendime u krijuan kushtet per funksionimin e Keshillit te ri Kombetar te Punes me mandat 3 vjecar.

Mbi bazen e ketyre dokumenteve te cituara me siper, me daten 19.12.2013 u zhvillua mbledhja e pare e Keshillit Kombetar te Punes per mandatin e ri. Mbledhja u drejtua nga Ministri i Ceshtjeve Sociale dhe Rinise, z. Erion Veliaj.

Mbas veprimtarive pershendetese, Keshilli degjoi nje informacion te hollesishem nga zv/Ministri i Financave per project-buxhetin e vitit 2014. Ne mbledhje u dhane mendime per ceshtjet qe do te diskutoje dhe konsultojte Keshilli gjate ketij viti.


Perfaqesuesit e FSASH/SPASH, te pranishem ne mbledhje, ngriten disa shqetsime te mesuesve qe lidheshin kryesisht me mosdhenien e shperblimit vjetor, ruajtjen e vendeve te punes, etj.

Ne vijim po botojme tekstet e plota te VKM Nr. 1060, date 14. 12. 2013 dhe Urdherit Nr. 287, date 18. 12. 2013.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M



Nr. 1060, datë 14.12.2013

P Ë R

**CAKTIMIN E NUMRIT TË PËRFAQËSUESVE TË ORGANIZATAVE
TË PUNËDHËNËSVE DHE TË PUNËMARRËSVE NË KËSHILLIN
KOMBËTAR TË PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 200, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës janë, si më poshtë vijon:

A. Për organizatat e punëdhënësve:

- | | |
|---------------------------------------------------------------------|-----------------------|
| a) Biznesalbania | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| b) Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ç) Shoqata Shqiptare e Turizmit (SHSHT) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| d) Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pijeve (SHBUP) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| dh) Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit (SHSHTI) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| e) Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë (BI&ISH) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| ë) Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve (DHKPV) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| f) Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS) | 1 anëtar, 1 kandidat; |
| g) Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH) | 1 anëtar, 1 kandidat. |

B. Për organizatat e punëmarrësve:

- a) Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH) 1 anëtar, 1 kandidat;
- b) Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPASH) 1 anëtar, 1 kandidat;
- c) Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë (SPMSH) 1 anëtar, 1 kandidat;
- ç) Federata Sindikale e Arsimit dhe Shkencës (FSASH) 1 anëtar, 1 kandidat;
- d) Sindikata Autonome e Ushqim, Tregtisë, Turizmit (SAUTT) 1 anëtar, 1 kandidat;
- dh) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) 1 anëtar, 1 kandidat;
- e) Federata e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë (FPISH) 1 anëtar, 1 kandidat;
- ë) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor (FSPSHSH) 1 anëtar, 1 kandidat;
- f) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Artizanatit dhe Manufakturës (FSPAM) 1 anëtar, 1 kandidat;
- g) Federata e Sindikatave të Shërbimeve Financiare, Tregtisë, Bankës e Turizmit 1 anëtar, 1 kandidat;

2. Emërimi i anëtarëve dhe kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, me propozimin e organizatave përkatëse të punëmarrësve dhe të punëdhënësve.
3. Vendimi nr.132, datë 24.2.2010, i Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës", shfuqizohet.
4. Ngarkohet ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
SOCIALE DHE RINISË**

ERION VELIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQENIES
SOCIALE DHE RINISË
MINISTRI

URDHER

Nr. 284, datë 18.12. 2013

Për

Emërimin e anëtarëve dhe kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve

Në mbështetje të nenit 200, pika 7 të ligjit nr.7961, date 129.07.1995, (i ndryshuar) “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të pikave 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1060, datë 14.12.2013, “Për caktimin e numrit të përfaqësuesve të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve në Këshillin Kombëtar të Punës”,

U R D H E R O J:

I.Emërohen anëtarë të Këshillit Kombëtar të Punës, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve personat e mëposhtëm:

I.1. Përfaqësues të organizatave të punëdhënësve

- | | |
|-----------------------|---------------------------------------------------------|
| 1. Luan Bregasi | BIZNESALBANIA |
| 2. Seyhan Pencabligil | Shoqata Shqiptare e Bankave |
| 3. Avenir Kika | Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë |
| 4. Zak Topuzi | Shoqata Shqiptare e Turizmit |
| 5. Luan Leka | Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pije |
| 6. Grigor Joti | Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit |
| 7. Kujtim Shkreli | Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë |
| 8. Lindita Legisi | Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve |
| 9. Avni Ponari | Byroja Shqiptare e Sigurimeve |
| 10. Enver Ferizaj | Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar |

I.2. Përfaqësues të organizatave të punëmarrësve

- | | |
|--------------------|----------------------------------------------------------------------|
| 1. Kol Nikollaj | Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë |
| 2. Taf Koleci | Federata e Punonjesve të Industrisë së Shqipërisë |
| 3. Lulash Aroni | Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor |
| 4. Hajdar Kanani | Federata e Sindikatave të Punonjësve të Artizanatit dhe Manifakturës |
| 5. Anisa Subashi | Federata e Sindik. të Shërb. Financiare, Tregtisë, Bankë dhe Turizëm |
| 6. Gëzim Kalaja | Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë |
| 7. Nevruz Kaptelli | Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë |
| 8. Sami Kariqi | Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë |
| 9. Xhafer Dobrusha | Federata Sindikale e Arsimit dhe Shkencës |
| 10. Bilbil Kasmi | Sindikata Autonome Ushqim,Tregtisë, Turizmit |

II. Emërohen kandidatë të Këshillit Kombëtar të Punës, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve personat e mëposhtëm:

II.1. Përfaqësues të organizatave të punëdhënësve

- | | |
|---------------------|---------------------------------------------------------|
| 1. Donika Mici | BIZNESALBANIA |
| 2. Jannis Kougionas | Shoqata Shqiptare e Bankave |
| 3. Agron Zala | Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë |
| 4. Enver Mehmeti | Shoqata Shqiptare e Turizmit |
| 5. Stefan Pinguli | Shoqata e Bizneseve të Ushqim-Pije |
| 6. Dritan Mezin | Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit |
| 7. Frederik Zhara | Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë |
| 8. Florian Zekja | Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve |
| 9. Abdyl Sarja | Byroja Shqiptare e Sigurimeve |
| 10. Agim Rahmeta | Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar |

II.2. Përfaqësues të organizatave të punëmarrësve

- | | |
|------------------|----------------------------------------------------------------------|
| 1. Edison Hoxha | Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë |
| 2. Imelda Kulari | Federata e Punonjesve të Industrisë së Shqipërisë |
| 3. Petrit Frangu | Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor |
| 4. Edina Daja | Federata e Sindikatave të Punonjësve të Artizanatit dhe Manufakturës |
| 5. Agron Beta | Federata e Sindik. të Shërb. Financiare, Tregtisë, Bankë dhe Turizëm |
| 6. Hiqmete Daja | Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë |
| 7. Shaban Duka | Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë |
| 8. Jonuz Xhetani | Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë |
| 9. Fatmir Bezati | Federata Sindikale e Arsimit dhe Shkencës |
| 10. Arben Malo | Sindikata Autonome Ushqim, Tregtisë, Turizmit |

III. Urdhëri i Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale nr. 549/1, datë 17.03.2010 “ Për emërimin e anëtarëve dhe kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës, përfaqësues të organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

nr 3032

ERION VELIAJ

MINISTER

